REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH
KESHILLI BASHKIAK BELSH

Belsh më 28/09/2026

PROCES – VERBAL
"I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 28.09.2026"

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

Janë prezent në mbledhje 17 këshilltarë:

1. Aurjola Bezati
2. Asqeri Kuqja
3. Nertila Uruçi
4. Blerim Kuqja
5. Ardjan Allkja
6. Bujar Blloku
7. Fadil Zdrava
8. Gazeli Hysa
9. Aleksander Idrizi
10. Ismail Paja
11. Avni Shtylla
12. Gezim Gjoshi
13. Nexhip Elezi
14. Erjon Qafa
15. Erion Gjoshi
16. Sami Uruçi
17. Kujtim Dervishi

- Kryetari i këshillit hap mbledhjen e Këshillit Bashkiak Belsh
- Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet me 17 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.1: Shprehje mendimi për projekt ligjin për Reformën Territoriale.
- Kujtim Dervishi : Sot do shprehim mendimin për bashkimin ose jo me Bashkinë Elbasan.
- Nertila Uruçi: Do të doja që të gjithë këshilltarët të votojnë kundër kësaj reforme.Nuk kemi një analizë të qartë të reformës së vitit 2014.
- Nertila Uruçi:Ne kemi identitetin tonë dhe po na largohet vendimarrja.Belshi ka specifikë tjetër nga Elbasani,kështu që nuk mund të bëhen bashkë.Përfaqësimi do të jetë vetëm 10.7% në Bashkinë e Elbasanit.Kemi potencial ekonomik të jemi bashki më vete.

- Kujtim Dervishi:Komsioni duhet të kishte bërë një analizë të plotë rreth funksionimit,kapaciteteve të Bashkisë Belsh.Aksesi i qytetarëve ndaj shëbimeve dhe identitetit të zonës së Dumresë. A ka altenativë tjetër?
  Në emër të grupit të Partisë Socialiste kërkoj që këshilltarët të reflektojnë. Ka pasur nga dëgjesat publike një indiferencë nga banorët. Jam i zhgënjyer nga reagimi i qytetarëve. Sot realizuam një takim shumë të shëndetshëm me disa qytetarë të Bashkisë.
- Ismail Paja:Nuk është bërë analiza e reformës së vitit 2014.Vëndi është shpopulluar dhe reforma e kaluar nuk ishte e frytshme.Nëpër komuna vetëm mblidhen taksa dhe asgjë tjetër.Shkollat dhe kopështet janë boshatisur. I kërkoj këshilltarëve të votojnë kundër sepse do na gjykojë populli.
- Aurjola Bezati: Replikoj me z.Ismail Paja sepse kryetari i këshillit foli në emër të grupit të PS.
- Nertila Uruçi: Jam dakord që qytetarët duhet të ishin më shumë prezent,por projekt ligji ka shkuar në parlament pa pasur dëgjesa publike.
- Gazeli Hysa: Ju duhet të ishit bërë krah me popullin. Pozita nuk mori pjesë në mblëdhjen e jashtëzakonshme.
- Kujtim Dervishi: Mbledhja u kërkuar pa mbaruar dëgjesat publike prandaj nuk morëm pjesë.
- Blerim Kuqja: Belshi duhet të mbetet bashki dhe reforma duhet ti shërbejë qytetarëve. Çfarë të mire solli reforma e 2014? Belshi është qëndra e Dumresë dhe ne duhet të forcojmë administratën këtu dhe jo ta largojmë.Shqipëria nuk ka nevojë për një reformë që të shpopullohet më tej.Belshi duhet të mbetet bashki dhe jo provincë e Elbasanit.
- Asqeri Kuqja: E ndjej detyrim moral që të them disa fjalë. Është moment historik dhe duhet të mos e anashkalojmë.Këtu fillon harresa ose lulëzimi i kësaj bashkie.Nga reforma e 2014 komunat u zbrazën ,kështu që do jemi ne nesër që do shpopullohemi. Unë mendoj që mos gabojmë. Jam kundra shkrirjes dhe bashkimit me Elbasanin
- Lodian Hasko ,qytetar dhe përfaqësues i shoqërisë civile: Ne si shoqëri civile përfaqësohemi me 350 firma që kërkojmë që Bashkia Belsh të qëndrojë.I kemi marrë me rradhë të gjitha kriteret.Nga kriteri i popullsisë /demografik jemi më shumë se Gramshi ose Peqini.Ky institucion duhet të qëndrojë. Nuk mund të vendosi Elbasani për fshatrat e fundit që janë 45 km larg. Ju kërkoj që të sillni një vendim në favor të qytetarëve.
- Kujtim Dervishi: Është momenti që ta hedhim në votim.Projekti mori gjithsej 10 vota abstenim dhe 7 vota kundër.
- Kujtim D: Duke qënë se qyetarët nuk kanë marrë pjesë ,prandaj dhe votojmë abstenim.
- Kalojmë te pika nr.2 për miratimin e 6 % dhe miratohet me 12 vota pro.
- Kalojëm te pika nr 3 e rendit të ditës për miratimin e vlerës financiare për përmbytjet. Hidhet në votim dhe nuk miratohet pika nr.3 me 10 vota pro dhe 3 kundra.

- **Mbyllet mbledhja me 2 vendime të miratuara.**

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT
Endri PEPA